

Agjenda




Edicioni i 19-të i e- Shoqëri.mk

“Inteligjenca artificiale dhe të drejtat e njeriut: Gjetja e ekuilibrit të duhur midis inovacionit dhe përgjegjësisë”

Inteligjenca artificiale hap mundësi të papara për inovacion në sektorë të ndryshëm, nga shëndetësia dhe transporti, deri te arsimi dhe argëtimi. Megjithatë, ky përparim i shpejtë i teknologjisë njëkohësisht ngre çështje kyçe për atë se si të mbrohen të drejtat themelore të njeriut. Arritja e ekuilibrit të duhur midis inovacionit dhe llogaridhënies është me rëndësi thelbësore për të siguruar një peizazh digjital që përfshin zgjidhjen e çështjeve të tilla si privatësia, paragjykimi, diskriminimi dhe përdorimi etik i IA-së për të mbrojtur të drejtat e njeriut. Ashtu siç inteligjenca artificiale vazhdon ta formësojë botën tonë, nevoja për të mbrojtur të drejtat e njeriut pa e ngulfatur përparimin teknologjik po bëhet sfidë më e madhe.

| NGJARJA KRYESORE | |
|---|--|
| 19.12.2023, Hoteli Marriot, Shkup (korridor, Ballroom I) | |
| Koha | Sesioni |
| 09:30 – 10:00 | Regjistrimi i pjesëmarrësve |
| 10:00 – 10:20 | <p>Epoka digjitale për qytetarët</p> <p>Në këtë epokë digjitale, vizioni i Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës është të udhëheqë rrugëtimin e vendit duke u bazuar në sferat e urtësisë dhe teknologjisë, duke i mbështetur me këtë rast fuqishëm standardet e BE-së, duke e trasuar rrugën drejt një të ardhmeje transformuese ku inovacioni dhe bashkëpunimi i shërbejnë përparimit dhe prosperitetit. Në këtë pjesë, Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës do të mbajë një fjalim të shkurtër frymëzues, ku do të flasë për angazhimet e Ministrisë dhe rëndësinë e epokës digjitale për qytetarët.</p> <p>Folës: Azir Aliu, Ministër i Shoqërisë Informatike dhe Administratës</p> <p>Moderatore: Milla Josifovska Danillovska, Koordinatorë e programeve në Fondacionin për Internet dhe Shoqëri - “Metamorfozis”</p> |
| 10:20 – 11:20 | <p>Etika në dizajn: Ndërtimi i zgjidhjeve teknologjike gjithëpërfshirëse dhe jo-ndërhyrëse</p> <p>Në epokën digjitale, dimensionet etike të teknologjisë nuk kanë qenë kurrë më thelbësore. Përparimi i shpejtë i zgjidhjeve dhe shërbimeve digjitale ka fuqinë ose të shërbejë si një forcë shtytëse për ndryshime pozitive ose të thellojë pabarazitë ekzistuese. Ky sesion e thekson rëndësinë e etikës në dizajn, duke e potencuar krijimin e teknologjisë që e respekton privatësinë, e promovon mosdiskriminimin dhe përmbush me të vërtetë nevojat e ndryshme të qytetarëve. Duke i adresuar këto shqetësime kritike etike, ne mund të punojmë drejt një të ardhmeje ku teknologjia shërben si një mjet për të fuqizuar dhe për të përfshirë, në vend që të marginalizojë apo të ndërhyjë në segmente të ndryshme të shoqërisë sonë.</p> |

| | |
|----------------------|--|
| | <p>Folës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Festim Halili, Drejtor, Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik - Zorica Vellkovska, Bashkëthemeluese e Qendra për Inovacion Social Blink 42-21 - Chris Shrishak, Bashkëpunëtor i lartë, Këshilli Irlandez për Liritë Civile (Gjermani) - Tamara Dimitrova, Studiuese dhe themeluese e Qendrës Arsimore “Scamper” <p>Moderatore: Marijana Jançeska, Specialiste për inkurajimin e hapjes dhe pjesëmarrjes, Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis</p> |
| 11:20 – 11:50 | Pushimi i kafes |
| 11:50 – 12:05 | <p>Fjalim i shkurtër frymëzues - Përdorimi i përgjegjshëm i inteligjencës artificiale</p> <p>Në ndjekjen tonë të inovacionit, është thelbësore të përdorim AI me përgjegjësi, duke mbajtur parasysh implikimet etike dhe ndikimin shoqëror. Përdorimi i përgjegjshëm i AI kërkon dizajn të kujdesshëm, transparencë dhe bashkëpunim të vazhdueshëm për të siguruar që teknologjia i shërben njerëzimit në mënyrë etike dhe të drejtë.</p> <p>Folës: Kamil Slivowski, Dizajnues i aktiviteve dhe përmbajtjeve mësimore, INCO (Poloni)</p> |
| 12:05 – 13:05 | <p>Dezinformatave me steroide: Kërcënim për integritetin e procesit zgjedhor</p> <p>Ky sesion e shqyrton ndikimin e rritjes së dezinformatave si një kërcënim për integritetin e procesit zgjedhor. Folësit në këtë sesion do të eksplorojnë sfidat e shumëanshme që paraqiten nga rritja e dezinformatave gjatë zgjedhjeve, duke shqyrtuar potencialin e tyre për të dëmtuar besimin e publikut, për të manipuluar perceptimet e votuesve dhe për të minuar bazat e integritetit zgjedhor.</p> <p>Folës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Jan Cingel, Themelues dhe president i “Strategic Analysis” (Sllovaki) - Bojana Kostiq, Hulumtuese e të drejtave të njeriut dhe teknologjisë (Bosnja dhe Hercegovina) (online) (TBC) - Fitim Gashi, Menaxher i projektit kundër Dezinformimit, Sbunker (Kosovë) <p>Moderator: Filip Stojanovski, Drejtor për Zhvillim dhe Partneritete, Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis</p> |
| 13:05 – 13:15 | <p>Mbyllja e konferencës</p> <p>Folës: Bardhyl Jashari, Drejtor Ekzekutiv, Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis</p> |
| 13:15 – 14:00 | Koktej dhe rrjetëzim |

| NGJARJA PËR TË RINJTË | |
|--|--|
| 18.12.2023, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë (Future Skills Next Center) | |
| Koha | Sesioni |
| 18:00 – 19:30 | <p>Cyber Shake - diskutim për të rinjtë: "Pse të mësoj kur ka Inteligjencë Artificiale?" A duhet të lejohet përdorimi i inteligjencës artificiale (IA) në universitete dhe shkolla? Pse dhe në çfarë mënyre? Sa dhe si e përdorin studentët dhe nxënësit inteligjencën artificiale në përgatitjen e detyrave të tyre? Sa të përgatitura janë universitetet për të luftuar keqpërdorimin e IA-së gjeneruese? A kanë ato mekanizma për të njohur tekstet e shkruara nga këto modele gjuhësore? Cilat janë pasojat e përdorimit të IA-së në universitete? Si mund të ndikojë IA-ja në sistemin arsimor? A duhet të rregullohet me ligj përdorimi i inteligjencës artificiale? A ka në plan Ministria e Arsimit të vendosë rregulla në vend lidhur me këtë çështje? Këto janë vetëm disa nga pyetjet të cilave do të përpiqemi t'u përgjigjemi dhe të diskutojmë në ngjarjen "Cyber Shake - diskutim për të rinjtë: "Pse të mësoj kur ka IA?"</p> <p>Folës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Jeton Shaqiri, Ministër i Arsimit dhe Shkencës - Adrian Besimi, Profesor në Universitetin e Evropës Juglindore - Sabrije Tefiki, koordinatore, Forumi për Ndryshime Arsimore - Zana Reçi, studente në Universitetin e Evropës Juglindore - Njomza Behadini, studente në Universitetin e Tetovës <p>Moderator: Fisnik Xhelili, gazetar, Portalb</p> <div style="text-align: right;">    </div> |

Mbështetja mediatike

